



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.565/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Rafet Haxhaj, dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit Naser Shatrit nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Naser Shatrit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Istog, me shenjën ZL.Anr.565/2017 e datës 03.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, më datë 03.11.2017, ka pranuar një ankesë përmes dërgesës postare nga Naser Shatri, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 22.10.2017 në Qendrën e Votimit 0622c/01R dhe 0622c/02D, në Llukac i Begut, ka pasur vjedhje të votave, sipas dëshmitarëve të cilët i kanë dhënë votën personit në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në postë, nga parashtruesi i ankesës me datë 30.06.2017, ndërsa në PZAP e njëjta është pranuar me datën 03.11.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.565/2017 të datës 03.11.2017, ndërlihet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në postë, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën

23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në postë me datë 30.10.2017 dhe është pranuar nga PZAP me datën 03.11.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.565/2017 më datën 03.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa .